



# POLITIKAT EKONOMIKE PERBALLE GLOBALIZIMIT



**Prof.Dr. Adrian CIVICI**  
**Universiteti European i Tiranës**

dhjetor 2012

- Në se sot në botë ka një debat për të cilin opinionet dhe qëndrimet janë të shumta e të ndryshme, ky është “ *efekti i fenomenit të globalizimit në ekonomitë nacionale dhe në nivelin e jetesës së popullsisë së çdo vendi* ».
- Gama e opinioneve fillon me vlerësimin se globalizimi përbën « *një oportunitet historik për ekspansion e zhvillim* » dhe përfundon me konkluzionin se ai po shkakton « *shkatërrimin e aktiviteteve dhe produkteve nacionale si pasojë e konkurrencës ndërkombëtare* ».
- Cili ka te drejte ?

- Politikanët, ekonomistët, sociologët, shoqëria civile, akademikët, etj., kanë tendencë që të gjykojnë e komentojnë aspekte të veçanta të tij dhe të nxjerrin konkluzione shpesh të njëanshme duke ju referuar,
- nga njëra anë realitetit „*që duket*“ (komunikimit të jashtëzakonshëm të njerëzve e mjeteve, informacionit, kostos së ulët të tij, etj.)...
- me një realitet tjetër „*që krijohet*“ nëpërmjet politikave ekonomike (kryesisht nëpërmjet liberalizimit të tregtisë së mallrave e shërbimeve), politikave financiare, tregjeve të punës, etj.
- Pikërisht kjo është dhe pika më delikate në politikat publike, programet qeveritare apo vizionin e institucioneve të çdo vendi

# GLOBALIZIMI



# Elementet kryesore te GLOBALIZIMIT

Dy dekadat e fundit jane karakterizuar nga nje tendence ne rritje drejt GLOBALIZIMIT

- C' fare nenkupton termi **GLOBALIZIM**
- Kur dhe si lindi ky fenomen ?
- Cilat jane disa nga tiparet kryesore te tij ?

# GLOBALIZIMI : i embel apo shkaterues?



# Elementet kryesore te GLOBALIZIMIT

Aktualisht ekziston nje debat nderkombetar ne shkalle te gjere nese :

« *Globalizimi ka bere qe rritja ekonomike ne vendet e zhvilluara dhe ato ne zhvillim te **permiresohet** apo te **perkeqesohet** ? »*





- Aktualisht, në gjithë botën ekziston një debat i gjerë nëse globalizimi ka bërë që rritja ekonomike në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim të përmirësohet apo të përkeqësohet???
- Edhe pse vendet e pa-globalizuara nuk korrespondojnë plotësisht me vendet më të varfra të botes, përsëri shumica e vendeve të pa-globalizuara përfshijnë vendet më të varfra.
- Për rrjedhojë, pabarazitë në të ardhurat për frymë dhe në standardet e jetesës ndërmjet vendeve të pa-globalizuara nga njëra anë, dhe vendeve të globalizuara dhe të pasura nga ana tjetër, janë bërë më të theksuara.



# Elementet kryesore te GLOBALIZIMIT

## Disa shifra qe ngjallin debat:

- 950 million njerez vuajne nga uria kronike ;
- 3.5 miliard njerez jetojne me te ardhura me te vogla se 2 \$/dite ;
- 7 njerezit me te pasur te SHBA – jane me te pasur se 47 vendet me te varfera te botes se bashku ku jetojne mbi 870 million njerez;
- Ne bote ka vetem 30 million traktore per 1.3 miliard ferma - mbi 85% e tyre ndodhen ne vendet e zhvilluara ;
- Shpenzimet per qente dhe macet ne vendet e zhvilluara jane me te medha se gjithe fondet e FAO-s....qe eshte institucioni kryesor boteror per zhvillimin e bujqesise dhe ushqimeve

# Elementet kryesore te GLOBALIZIMIT

- Ne vendet e zhvilluara konsumi ushqimor varion ne intervalin 2800 – 3500 kal/dite/person,
- nderkohe qe ne vendet e varfera kjo shifer varion ne 1200 – 2000 kal/dite/person ;
- PBB/fryme ne vendet e zhvilluara : 18000 – 39000 USD/person ne vit
- ne vendet e varfera PBB/fryme/vit eshte 300 – 2000 USD/per/vit ;

- Por, faji për këtë pabarazi..a mund ti atribuohet procesit të globalizimit? Statistikat dëshmojnë se janë vendet e globalizuara ato që rriten me shpejtësi, ndërkohë që ato të paglobalizuara ngelen në vend ose pësojnë rënie.

- A duhet që globalizimi të konsiderohet si shkaku i theksimit të pabarazive gjatë dy dekadave të fundit midis vendeve të pasura nga njëra ane dhe vendeve në zhvillim e të përfshira në globalizim dhe vendeve më të varfra në zhvillim nga ana tjetër?
- Megjithë kritikën kundër globalizimit, **asnjë model alternativ për rritjen dhe zhvillimin botëror nuk është hartuar nga ata që e kundërshtojnë globalizimin**, apo nga ata që e fajësojnë atë për rritjen e varfërisë dhe pabarazisë në botë.

- Sot ne bote ka me shume se 500 million njerez te lidhur rregullisht me internetin ;
- Kosto e komunikimit nderkombetar ka rene me 80% ne periudhen 1940-1970 dhe me 90% ne periudhen 1970-2000 ;
- Kosto e transportit ka ndjekur te njejten tendence : eshte ulur me me shume se 2/3 ne periudhen 1930-2000;
- Pengesa qe shkaktonin barrierat doganore po zhduket : ne vitin 1947 taksa mesatare doganore mbi produktet e perpunuara ishte 47%; ne 1980 ajo arriti ne 6% dhe mbas viteve 2000 ajo po shkon ne vetem 3%!

# Elementet kryesore te GLOBALIZIMIT

- Ne 30 vitet e fundit, vendet e zhvilluara kane njohur nje „zhvillim human“ (jetegjatesia, zhvillimi arsimor, etj.) me nje rritem vjetor 2.7%; nderkohe qe vendet e varfera kane njohur nje rritem vjetor vetem prej 0.9%;
- Sherbimet shendetsore, niveli Sot ne bote ka tendence te dominoje nje lloj kulture e quajtur „*kulture globale*“ : coca cola, malboro, levi's, macdonals, etc; po dominojne shijet dhe zgjedhjet e mbare globit

- **Ne nuk jetojmë në një botë homogjene.**
- Aktualisht evidentohen të paktën **5 nivele të ndryshme zhvillimi për vendet e planetit** : (1)vendet e industrializuara ; (2)ekonomitë në tranzicion ; (3)vendet e zhvilluara të avancuara ; (4)vendet në zhvillim ; (5)vendet e varfra dhe ato me konflikte permanente.
- Vendet e veçanta dhe grupet sociale të tyre nuk kanë të njëjtën forcë e mundësi për të përfituar nga tendencat globale dhe avantazhet e globalizimit.
- Humbjet po ju faturohen gjithnjë e me shume atyre vendeve apo grupeve sociale qe nuk janë ne gjendje te reagojnë me politika cilësore publike apo veprime konkrete « mbrojtëse», dhe kryesisht vendeve të grupit të katërt e të pestë.

# Elementet kryesore te GLOBALIZIMIT

## **Mbrojtesit e globalizimit :**

- Stimulon zhvillimin ekonomik e social te cdo vendi ;
- Rrit efektivitetin e prodhimit dhe sherbimeve ;
- Ndhmon zhvillimin e tregetise boterore ;
- Ndikon ne rritjen e nivelit te jeteses per vendet e integruara ;
- Eshte i favorshem per zgjidhjen e problemeve ne menyre globale;
- Ndhmon ne shkembimin e ideve dhe kulturave ne favor te zhvillimit ;
- Stimulon sistemet demokratike dhe respektimin e te drejtave te njeriut;



# Elementet kryesore te GLOBALIZIMIT

## Kundershtaret e globalizimit - argumentat :

- Thellon ndarjen dhe pabarazine ndermjet vendeve e popujve ;
- Krijon premisa per dominimin e botes nga vendet e fuqishme dhe korporatat shumekombeshe ;
- Zhvillimi human po dominohet nga interesat e tregjeve financiare ;
- Eleminon mundesine e vendeve te vogla / te varfera qe te mbrojne interesat e tyre socio-ekonomike dhe ushtrimin e sovranitetit ;
- Shkateron kulturat e vendeve te vogla ne emer te nje kulture dominuese globale qe eshte kryesisht kultura amerikane ;
- Nuk nxit aspak zhvillimin.

# Elementet kryesore te GLOBALIZIMIT

Cdo dekada ka nje koncept apo teori te saj dominues,

- Vitet 70, fjala e dites : “**dinamizmi**”. Firmat dhe kompanite duhet te vepronin sa me dinamikisht dhe jo statikisht ne treg.
- Vitet 80, nocioni i preferuar : “**strategjia**”, qe do te thote se, per te qene te suksesshme, firmave dhe qeverive ju duhej te vepronin mbi baze programesh strategjike.
- Fillimi i viteve 90, tema e diskutimit : **globalizimi dhe ekonomia e Re.**

# Elementet kryesore te GLOBALIZIMIT

## Aspektet themelore te GLOBALIZIMIT :

- Globalizimi ne shije,
- Globalizimi ne prodhim (perfshire ketu dhe ate financiar)
- Globalizimi ne tregjet e punes.



# Elementet kryesore te GLOBALIZIMIT

## Globalizimi ne Shije

Revolucioni i dekadës së fundit në telekomunikacion dhe transport solli një bashkërendim shijesh dhe kulturash në mbare botën.

Shijet po behen globale - firmat përgjigjen duke prodhuar **produkte të mirefillta globale**.

Lista e produkteve globale po zgjerohet - po ecet drejt një **“supermarketi global”**.

Konsumatorët duan produkte të ngjashme, dhe suksesi për prodhuesit nënkupton : **produkte të standartizuara dhe çmime të njëjtesuara në të gjithë botën.**

# Elementet kryesore te GLOBALIZIMIT

## Globalizimi ne Prodhim

Me shtimin e shpejte te korporatave globale, **globalizimi ka perfshire edhe prodhimin e mallrave dhe sherbimeve.**

Keto korporata :

- drejtohen nga menaxhere nderkombetare,
- kane baza kerkimore dhe prodhimi ne shume vende,
- perdorin pjese nga burimet me te lira boterore,
- shesin produktet e tyre ne te gjithe boten,
- financojne operacionet nga aksionere nga e gjithe bota.

# Elementet kryesore te GLOBALIZIMIT

- Globalizimi ne prodhim ka avancuar shume - eshte e veshtire te percaktohet **kombesia e shume prej produkteve**
- **Transferimi i jashtem i imputeve** nuk eshte nje menyre qe korporatat mund te shtojne fitimet, por nje kerkese e tregut qe ato **te mbeten konkuruese;**
- **Globalizimi ne prodhim** ka avancuar shume saqe tashme eshte e veshtire te percaktohet **kombesia e shume prej produkteve;**

# Elementet kryesore te GLOBALIZIMIT

## ● Globalizimi ne Tregjet e Punes

Pune te cilat beheshin ne SHBA apo vende te tjera industriale tani behen dhe kushtojne shume me pak ne disa vende ne zhvillim.

Kjo ndodh edhe per pune qe kerkojne aftesi te larta kompjuterike dhe inxhinerike.

Po kuptohet se ekziston ne bote nje force pune konkurruese, e cila eshte e gatshme dhe e afte ta beje pune per nje pagese mjaft me te ulet.



# Elementet kryesore te GLOBALIZIMIT

## Globalizimi: i pashmangshem dhe i rendesishem

I rendesishem → **promovon efektivitetin;**

I pashmangshem → **e kerkon konkurenca  
nderkombetare.**

# Elementet kryesore te GLOBALIZIMIT

## Globalizimi, Rritja Ekonomike, dhe Zhvillimi

- Globalizimi eshte nje **perberes esencial i rritjes.**
- Ka korelacion pozitiv ndermjet **globalizimit dhe rritjes**

# Te Ardhurat Vjetore Reale Mesatare te Ponderuara per Fryme sipas PPP-se ne Rajone te Ndryshme te botes per dy periudhat e globalizimit, 1960-80 dhe 1980-00

<b>Rajoni</b>	<b>1960-1980</b>	<b>1980-2000</b>
Azia Lindore	2.85	6.12
Azia Jugore	0.55	3.00
Azia	1.98	4.86
Kina dhe India	1.74	5.75
Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore	3.21	0.15
Afrika Sub-Sahariane	1.29	-0.58
Amerika Latine	3.13	0.08
Vendet ne Zhvillim	2.12	3.11
Vendet ne Zhvillim, pa Kinen & Indine	2.51	0.69
Europa Lindore	4.03	-1.88
Bota e pa-Industrializuar	2.32	2.84
Bota e Industrializuar	3.27	1.55

# Elementet kryesore te GLOBALIZIMIT

- **Azia**, mire gjate 60-80 dhe spektakolare ne 1980-2000
- **Europa Lindore** - shume mire ne 1960-80, dobet gjate se dytes, si rezultat i kolapsit ekonomik dhe tranzicionit.

**Lindja e Mesme** dhe **Afrika Veriore** - mire gjate periudhes se pare, por keq gjate se dyte per shkak te trazirave politike dhe luftrave.

**Afrika Sub-Sahariane** - mire ne periudhes e pare - u varferua me shume gjate te dytes : rrjedhoje e mungeses se stabilitetit politik, luftrave, thatesirave, dhe sides.

**Amerika Latine** - mire gjate periudhes se pare, por stanjacion gjate se dytes, kryesisht per shkak te krizave ekonomike dhe politke.

**Vendet ne zhvillim** - ecuri te pranueshme gjate periudhes se pare dhe akoma me te mire gjate te dytes.

# Rritja e te ardhurave vjetore reale mesatare per fryme sipas PPP-se ne Vendet e Pasura, vendet e Globalizuara dhe Jo-Globalizuara

1960-70, 70-80, 80-90, 90 - 2000

● Vendet e Pasura	4.7	3.1	2.3	2.2
● Globalizues	1.4	2.9	3.5	5.0
● Jo-Globalizues	2.4	3.3	0.8	1.4

# Elementet kryesore te GLOBALIZIMIT

**Per vendet ne zhvillim te perfshira ne procesin e globalizimit** : rritja e PPB reale/fryme sipas PPP eshte permiresuar gjate cdo dekade nga 1960-00 (*dmth, ato vende per te cilat raporti tregeti/PPB ka ardhur ne rritje*),

Rritja e ka **kaluar rritjen mesatare te vendeve te pasura** dhe atyre te pa-globalizuara.

# Elementet kryesore te GLOBALIZIMIT

Ne fillimet e procesit rritja mund te jete me e shpejte edhe ne mungese te liberalizimit dhe globalizimit, por ndersa kombet zhvillohen:

*eficensa ekonomike qe lidhet ngushte me liberalizimin dhe globalizimin, merr gjithnje e me shume perparesi.*



- ***Shoqerite e sotme post-industriale po karakterizohen nga 5 shkeputje apo nderprerje te elementeve te tyre thelbesore qe ne nje fare menyre jane bere simboli i vendeve te zhvilluara.***
- Te lindura rreth 30 vjet me pare me daljen e kompjuterit te pare “Apple”; me nje shkeputje nga modeli fordist i organizimit te punes; me nje revolucion kulturor e levizje sociale te fuqishme si ajo e viteve 68-te; me nje revolucion financiar te viteve 90-te qe kontrollin e ndermarjeve dhe firmave ja kaloi burses duke i bere aksioneret me te mbrojtur e favorizuar se punonjesit, dhe se fundi me fenomenin me prezent sic eshte ai i “globalizimit”,
- tashme keto vende po hyjne ne nje faze te re zhvillimi e funksionimi te cilesuar si “**post-moderne**”.